



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:148226

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524643

P.nr.716/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale kundër të pandehurit M. Sh., për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par.1 të Kodit Nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.15/2016 e datës 18.10.2016, jashtë seancës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 par.1 nën par 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP), me datën 29.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.15/2016 e datës 18.10.2016 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: M. Sh., i lindur me datë ..., me vendbanim në rrugën “...” Mitrovicë, me numër të letërnjoftimit ..., për veprën penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par.1 të KPRK-së, **për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.**
- II. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Pala e dëmtuar KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.15/2016 të datës 18.10.2016, kundër të pandehurit: M. Sh., për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e çështjes, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare përkritazi me afatet e parashkrimit, ka konstatuar se në këtë lëndë penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të pandehurin M. Sh., për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se i pandehuri M. Sh. veprën penale dyshohet t'a ketë kryer nga data e pavërtetuar e deri me datë 20.11.2015 dhe që nga ajo kohë e deri më tani kanë kaluar mbi tetë (8) vite.

Në nenin 106 paragrafi 1 nën par 1.5 të KPRK-së, është përcaktuar se *“ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”* dhe, neni 107 paragrafi 8 përcakton se *“ Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit ”*.

Në rastin konkret i pandehuri M. Sh. është akuzuar me dyshimin se kanë kryer veprën penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par.1 të KPRK-së, ku dënimi i përcaktuar me këtë kod për këtë vepër penale është me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, ndërsa vepra penale dyshohet se është kryer nga data e pavërtetuar e deri me datë 20.11.2015, dhe që nga koha e dyshimit se i pandehuri ka kryer veprën penale të lartcekur e deri më sot kanë kaluar mbi tetë (8) vite, e që ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 106 paragrafi 1 nën par 1.5 lidhur me nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së.

Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur me datën 20.11.2021, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit të lartcekur, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale që është akuzuar, kjo Gjykatë ka marrë aktvendim, e ka hedhur akuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 par. 3 të KPP-së.

Andaj, në bazë të lartcekurave, konform nenit 106 par.1 nën par 1.5 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së, si dhe nenit 357 par.1 nën par 1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.716/2016, datë: 29.03.2024

G j y q t a r j a
Benita Berisha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.